



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 348 / Prot.  
3

Tiranë, më , 13. 4. 2022

**VENDIM**

Nr. 08 , datë 05.04.2022

**“PËR HAPJEN E KURSEVE TË TJERA EKSTRAKURRIKULARE TË GJUHËVE TË  
HUAJA, NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA, TË UNIVERSITETIT TË  
TIRANËS”**

Bazuar në nenin 38, pika 3, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; dhe në nenin 31, gërma “p”, të Statutit të UT-së ; në Vendimin nr.146, datë 25.11.2021, të Dekanatit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, si dhe në vijim të Vendimit nr.34, datë 21.11.2018, të SA, në mbledhjen e datës 05.04 .2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

**VENDOSI:**

I. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, për hapjen e kurseve të tjera ekstrakurrikulare në gjuhët e huaja dhe nivelet, si më poshtë:

1. Për gjuhën greke, niveli B1, B2, C1
2. Për gjuhën turke, niveli B1, B2, C1
3. Për gjuhën ruse, niveli B1, B2, C1
4. Për gjuhën hebraike, niveli B1, B2
5. Për gjuhën arabe, niveli A1, A2, B1, B2, C1
6. Për gjuhën kroate, niveli A1, A2, B1, B2

II. T'i propozojë Bordit të Administrimit të UT-së, planet financiare për secilin kurs të gjuhëve të huaja dhe për çdo nivel, për miratimin e tyre.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



**Prof. Dr. Artan Hoxha**